



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE



Nr. 13130 Prot,  
Datë 28.12. 2020

URDHRI I PSIKOLOGUT



Nr. 640 Prot,  
Datë 28.12. 2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

*NDËRMJET*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

*DHE*

URDHRIT TË PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet në Tiranë, sot më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2020, ndërmjet palëve:

- **Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve**, me adresë: Rruga “Zef Serembe”, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Agim Ismaili**,

dhe

- **“Urdhrit të Psikologut” në Republikën e Shqipërisë**, me adresë: Blv.Gjergj Fishta, Nd.24, K.2, Ap.9, Tiranë, përfaqësuar nga **Znj. Valbona Treska**.

#### **Duke marrë në konsideratë:**

- misionin madhor të reformës në drejtësi, për transformimin e sistemit penitenciar në një mjedis me qasje restauruese,
- objektivat strategjik të kësaj reforme, për krijimin e mundësisë për rehabilitim dhe riintegrim të personave të privuar nga liria,
- rëndësinë e ushtrimit të profesionit të psikologut me zotësi, me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor,
- zhvillimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit / aseteve njerëzore për të arritur standardet me qëllim trajtimin e duhur dhe njerëzor,
- nevojën e studimeve, analizës së të dhënave, vlerësimit të programeve ndërhyrëse me qëllim krijimin e mundësisë për rehabilitim dhe riintegrim, për komunitete më të sigurta;

nënshkruhet kjo marrëveshje për angazhimin e palëve si më poshtë:

#### **NENI 1**

#### **OBJEKTI**

- a) Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë midis dy institucioneve për rritjen e standardeve, në ofrimin e shërbimit social në Institucionet e Zbatimit të

Vendimeve Penale, si edhe zhvillimin e praktikës profesionale në përputhje me parimet e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë.

## **NENI 2**

### **BAZA LIGJORE**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në :

- b) Ligjin Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuave me burgim dhe të paraburgosurve”;
- c) VKM Nr. 437 datë 20.05.2015 Për Miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve;
- d) Ligjin Nr.7850, datë 29.07.1994, të ndryshuar për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë;
- e) Ligjin Nr.40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”;
- f) Statuti i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë;
- g) Kodi i Etikës dhe Deontologjisë së Psikologut;
- h) Rregullorja e Edukimit në Vazhdim për Psikologët

## **NENI 3**

### **FUSHA E ZBATIMIT**

Kjo marrëveshje zbatohet përmes realizimit të bashkëpunimit midis dy institucioneve në studime, trajnime të stafit, veçanërisht të specialistëve të shërbimit social, seminare, konferenca, proceset e vlerësimit të shërbimeve, standardeve dhe kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve, si dhe në hartimin e politikave të reja sociale, programeve dhe projekteve të shërbimeve për grupe dhe komunitete në nevojë.

## **NENI 4**

## ROLET DHE DETYRIMET E PALËVE

### 4.1 Urdhri i Psikologut në Shqipëri merr përsipër:

Të bashkëpunojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve sa i takon:

- a) Ngritjes së kapacitetit të punonjësve të shërbimit social, duke hartuar programet, modulet dhe metodologjinë e trajnimit;
- b) Nxitjes së organizimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim brenda fushës së kompetencës;
- c) Ofrimit të ekspertizës për studime, programe dhe projekte lidhur me rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve;
- d) Ndarjes së perspektivave analitike, vlerësimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e politikave, programeve, projekteve, përfshirë legjislacionin;
- e) Ndërmarrjes së studimeve për çështje sociale duke përfshirë në axhendë dhe prioritet, nevojat dhe interesat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;
- f) Të bashkëpunojë për nisma në fushën e komunikimit, advokacisë dhe promovimit të drejtësisë sociale për grupet vulnerable.

### 4.2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve merr përsipër:

- a) Të përfshijë ekspertët respektivë në grupe të përbashkëta pune me qëllim kryerjen e studimeve shkencore mbi çështje hipotetike; analiza; ndërtimin e aseteve njerëzore; konferenca; vizita studimore; debate për probleme që lidhen me fushën;
- b) Të krijojë grupe të përbashkëta pune për angazhime që lidhen me politikat, programet dhe projektet në fushën e kompetencës profesionale;
- c) Të ofrojë aktivitete të edukimit në vazhdim për psikologët, që varen drejtpërdrejt apo nëpërmjet institucioneve të varësisë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- d) Të organizojë grupe të përbashkëta pune për vlerësimin e performancës dhe të standardeve në përmbushje të misionit të sektorit të burimeve njerëzore për komponentin e përkujdesjes ndaj stafit.

### 4.3. Veprimtari të përbashkëta të palëve

Palët nëpërmjet strukturave të tyre kompetente, marrin përsipër të kryejnë bashkarisht:

- a) Hartimin dhe miratimin e planit të veprimit me afate të përcaktuara për zbatimin e kësaj marrëveshje.
- b) Kryerjen e vlerësimeve periodike, në lidhje me zbatueshmërinë e marrëveshjes çdo vit, dhe mundësinë e përmirësimit të saj.

#### NENI 5

### KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë dy - vjeçare, me të drejtë rinovimi.

#### NENI 6

### PERSONAT E KONTAKTIT

Secila nga palët, merr përsipër të përcaktojë personat e kontaktit në lidhje me ndërveprimin institucional, brenda një muaji, nga momenti i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

#### NENI 7

### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve, zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

#### NENI 8

### DISPOZITA TË FUNDIT

- a) Palët janë të detyruara të respektojnë këtë marrëveshje, për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në nenin 5 të saj.
- b) Secila palë merr përsipër përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshje, pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.
- c) Kjo marrëveshje hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje.

PËR DREJTORINË  
E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE



PËR URDRIN  
E PSIKOLOGUT

Znj. VALBONA TRESKA

5